

DANIELE MENCARELLI
GJITHMONË NË KTHIM
ROMAN

BOTIMET TOENA

DANIELE MENCARELLI

GJITHMONË NË KTHIM

roman

Përktheu nga italishtja: Erion Gjatolli

BOTIMET TOENA

Autor: Daniele Mencarelli
Titulli: Sempre tornare
Botoi në italisht: Mondadori, 2021

Questo libro é stato pubblicato con il contributo del Ministero degli Affari Esteri e della Cooperazione Internazionale italiana.

Ky libër u publikua me kontributin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Kooperacionit italian.

Botuese: Irena Toçi

Përgatiti për shtyp: Irena Toçi
Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj
Kopertina: Gea Qëndro

ISBN 9789928960177

© 2021 Mondadori Libri S.p.A., Milano
© 2025 Botimet TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.
Kutia Postare 1420
E-mail: botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al/>

Luftëtarëve.
Të çmendurve.
Të panjohurve.

Ata bërtasin, ama unë nuk i dëgjoj.

Sillen rreth meje, më shtyjnë, por asgjë dhe askush nuk mund të ma ndryshojë mendjen.

- Hajde, lëri këto dhe hip në makinë.

Alesioja më kap për krahu me forcë, është më i gjatë dhe më i bëshëm se unë, por unë nuk lëviz.

- Hë se nuk tallemi më, e kam seriozisht, bëm' cik gallat', po kaq ishte, të japim fjalën, kaq.

Klaudioja, që e ka zakon të pështyjë kur flet, është si shatërvan që stërpik pështymë mes çdo sharjeje që thotë.

I shoh të dy.

- Edhe një herë po jua them, s'ka lidhje me natën e mbrëmshme, *kam vendos' të kthehem në shpi vetëm*, mami nuk më pret para datës 31, nuk është fare në *shpi*, dua të rri pak vetëm, kaq.

Alesioja kalon duart mes flokëve të njomur nga djersa, me sytë e lodhur nga nata që u bë ditë, pa as edhe një minutë gjumë.

- Kaq? E kupton që jemi në Misano, domethënë katërqind kilometra larg *shpisë*? Të duket normale kjo që po thua? Je në terezi, Daniele? Se mua s'më dukesh mirë. Më duket ke akoma inatin e mbrëmshëm.

Nuk dua të bëj debat, por nuk shoh rrugë tjetër.

- S'po di si t'jua them, unë po iki, *shifna* në shtator.

Marr valixhen dhe i hyj kësaj gjuhe asfalti, pa e ditur se ku do të më çojë.

- Daniele, për her' t'fundit po ta them, hip në makinë, - më arrin zëri i Alesios.

Fjalëve të tij u përgjigjen hapat e mi, dhe me siguri nuk i afrohen.

- Kij kujdes, mos i beso asnjëriu!

Kur kthej kokën, shoh që në fytyrë nuk arrin ta fshehë shqetësimin, dhe si përgjigje i buzëqesh.

- *S'kan' ça të më vjedhin*. Mos kini merak. Bëfshi qejf!

Kthehem edhe një herë nga rruga përpara meje. Dëgjoj të mbyllen dyert e makinës që na shëtiti nëpër Itali, motorin që ndizet, pastaj rrotat që bëjnë detyrën.

Kur kthehem, Volkswagen-i i Alesios është thjesht një makinë mes të tjerave, me turirin e drejtuar në kahun e kundërt me atë që sapo mora unë.

Nuk e di sa peshon valixhja, me saktësi, por sikur të vija bast, do të thosha të paktën njëzet kile, e ngre dhe dal në buzë të rrugës. Orë nuk kam mbajtur asnjëherë, por me siguri do të jetë mesditë, duke qenë se dolëm nga "Cocoricò"-ja në shtatë të mëngjesit, dhe kaluam nga Negroni te kafeja pa as edhe një briosh në mes.

Duket sikur dielli ka vënë në shënjestër qafën time, tani bie vertikalisht mbi mua, më rëndon duke ma bën edhe më të të mundimshme këtë rilindje të ngadalte pas turpit që përjetova gjatë natës. Pas figurës që bëra mbrëmë. Duhej të ishte festa e përsosur. Mesi i gushtit, Dita e Shën Mërisë te “Cocoricò”-ja, dymbëdhjetë orë delir i shfrenuar, një nga ato ngjarje që nguliten në kujtesë përgjithmonë. Dhe ky duhej të ishte vetëm fillimi, preludi i pushimeve të para pa familjen, dy javë lirie të panjohur deri më sot, vetëm instinkte për t’u përmbushur, unë si kushdo tjetër. Mendoza se gjithë jetën, edhe kur të plakesha, do të kthehesha te kujtimi i këtyre ditëve, vetëm për t’i konfirmuar vetes, i mposhtur nga nostalgjia: “Po vera e ‘91-shit, vera ime e parë, nuk mund të përshkruhet, isha vetëm shtatëmbëdhjetë vjeç”.

Por nuk qëlloi ashtu.

Nuk i dihet si shkojnë punët me mua.

Nata kaloi si mos më keq, figurën e keqe që bëra do ta mbajnë në gojë gjatë të gjithë shokët e mi.

Por nuk është kjo arsyeja pse jam këtu, vetëm, në një rrugë që nuk e di se ku shpie, me një valixhe të rëndë si një bllok mermeri drejtkëndor, me ngjyrë të gjelbër.

Nuk është kjo arsyeja.

Nuk e zë në gojë me askënd.

Veç atyre që nuk mund të më kthejnë përgjigje.

Kafshët. Natyra. Bukuria e pamasë e gjërave.

Duhet të kuptoj.

Jam këtu sepse duhet të kuptoj.

Nuk mund të hiqem sikur s'ka ndodhur gjë.

Nuk kam faj unë nëse shoh kudo një vazhdimësi për t'u zbuluar, kudo një enigmë që kërkon nga unë ta zgjidh, sikur të ishte vërtet e mundur.

Nuk kam faj unë nëse çdo gjest, ndjenjë, frymëmarrje, kërkon të dijë nga cila anë qëndrojmë, sepse në çdo gjë ka një betejë, betejën që mbaj në zemër që nga dita kur më nxorën nga barku i nënës.

Çdo ditë në gjoks më shpërthen një duel, gjithmonë i njëjti.

Njëri nga luftëtarët quhet Gjithçka. Kundërshtari i tij quhet Asgjë.

Çdo gjë që përjetoj unë duan ta fitojnë ata. Njëri kundër tjetrit, ndërsa në lojë është jeta ime, jam unë toka që duan të zaptojnë, që ngahera, përgjithmonë.

Babai më thotë se të jesh i rritur do të thotë të gjesh rrugën e mesme, të dish të jetosh në zonën gri, sepse nuk mund të jetë çdo gjë vetëm e bardhë dhe e zezë. Ndoshta ka disi të drejtë. Por një gjë e ka gabim. Sepse mes Gjithçkasë dhe Asgjësë nuk mund të ketë diçka në mes. Nuk mund të ekzistojë grija. Tek unë nuk ka asnjë mundësi kompromisi.

Jemi bij të Gjithçkaje, ose të Asgjësë.

Nga njëra anë Zoti, nga ana tjetër Kaosi.

Vetëm se nuk thuhet këto gjëra.

Duhet të hiqem sikur gjithçka është normale, sikur jeta, bota, pikat e djersës që më rrëshkasim në shpinë,

sikur çdo gjë është një ngjarje e jetuar më parë, e arkivuar.

Nuk jetoj dot më në këtë shfaqje, brenda këtij gardhi ku fiton ai që habitet më pak, duke i marrë si të mirëqena zbulimet që kanë bërë të tjerët përpara meje.

Kam pesëmbëdhjetë ditë kohë, shumë rrugë për të bërë.

Ky udhëtim do të jetë kthesa në jetën time.

Do të mundohem të kuptoj. Përgjigjet do të vijnë. Ndoshta atje ku nuk i pres.

Si kjo lulja e verdhë, për shembull, që ka mbirë në buzë të rrugës. Ndoshta po ta shoh ngultas, me dashuri, do të më flasë.

Do të më thotë gjithçka.

Autostopi është një disiplinë më vete. Si sporti ose profesionet e tjera. Ka rregulla të sakta, të paktën nëse do të fitosh, pra të udhëtosh.

Unë e di mirë.

Isha katërmëdhjetë vjeç herën e parë që ngrita gishtin e madh për të bërë autostop dhe që atëherë e kam bërë vazhdimisht. Bëj autostop për të shkuar në shkollë, për të shkuar në futboll, për sa kohë luaja. Me autostop jam edhe më i përpiktë se shumica e shokëve të mi që lëvizin me motor, pa asnjë shpenzim. Për më tepër, ashtu kam mundësinë të njoh botë të ndryshme. Brenda makinave luksoze ose të mbaruara, ka histori pa fund. Madje me shumë njerëz kam krijuar miqësi të qëndrueshme. Për shembull tani e di që në mëngjes kalon Umbertoja, i cila ka një furrë buke, dhe nga Veletri shkon çdo ditë në Albano. Kalon gjithmonë përpara orës 7, prandaj është detyra ime të dal te kryqëzimi pak më herët. Unë i flas për orët e mësimi,

ai më tregon shqetësimet për të bijën që jeton në Piosasko, afër Torinos.

Me shumë prej tyre, si me Umberton, nuk ka më nevojë as të ngre gishtin. Thjesht shihemi në sy dhe kaq mjafton.

Për të qenë një autostopist i mirë, shikimi është kyç. Shoferët nuk ndalojnë prej gishtit të ngritur, ai është thjesht kod, asgjë më shumë; punën më të vështirë e kanë sytë. Sapo makina afrohet, duhet t'i ngulësh sytë e tu te ata të shoferit. Vetë bebet duhet të flasin. Duhet të përcjellin pastërti shpirtërore, në mos edhe pafajësi, dhe duhet të thonë: "Na merr për një copë rrugë, mos kij merak." Buzëqeshja nis vetëm kur dialogu me sy është përmbyllur. Është gjesti përfundimtar. Natyrisht, edhe trupi ka pjesën e vet. Gjatë manovrës, duhet të lëvizësh ngadalë drejt mesit të rrugës, si për ta bërë ndalesën një veprim të natyrshëm, të pashmangshëm. Të paktën, kjo është shpresa. Ka ndodhur disa herë edhe që ndonjë shofer të devijonte vrik për të mos më shtypur.

Veçse tani, në rrugë, përveç vapës mbytëse, kalon një makinë çdo dhjetë minuta. Pa lëndën e parë, nuk arrihen rezultate, edhe pse mund të jesh kampion olimpiq autostopi. Thjesht mbetesh vetëm mbi asfalt.

Një makinë e bardhë po afrohet. Duhet të jap maksimumim.

Performanca e arrin qëllimin: shoferi ndalon.

Është një Peugeot 205 pa çati, fringo e re. Në timon është një burrë të cilit nuk arrij t'ia përcaktoj

moshën, me siguri ka të paktën tridhjetë vjeç. Ka flokë kaçurrelë, të verdhë, një këmishë të bardhë që i vë në pah lëkurën e nxirë, në të kuqërremtë; them se mund të jetë nga veriu, nga kabina e hapur vjen zëri i radios.

- Për ku je nisur?

Hap krahët, i buzëqesh.

- Unë kam rrugë të gjatë, jam për në Romë, afër Kasteli Romani, s'e di a e ke parasysh.

Biondi ngelet për një çast i habitur, pastaj qesh me të madhe.

- *Qeke* çun me fat. Unë isha për fundjavë në plazh, *tashi* duhet të kthehem në punë, punoj si stjuard në aeroportin e Çampinos. *Po të çokam deri në shpi, me një llaf.* Hajde.

Planet që ndërtojmë me aq shumë kujdes dhe imagjinatë janë bërë për t'u përmbysur nga ngjarjet e jetës. Mjafton fare pak.

Po tani?

Ama dyshimi zgjat aq pak sa një frymëmarrje.

- Jo, rrofsh. Dua të bëj edhe ndonjë xhiro këtej vërdallë, faleminderit gjithsesi, me të mira.

Buzëqeshja rrezatuese i shuhet biondit në fytyrë. Është i befasuar, nuk kupton.

- Je i sigurt? Më the që duhet të shkosh afër Romës.

Pastaj më vëzhgon nga koka te këmbët dhe duket sikur vë re diçka.

- A je mirë? Se s'dukesh shumë në terezi, je i sigurt, *me një llaf?*

Nuk më njeh, por në shikimin e tij dalloj një interesim të singertë për mua.

- Po, mos e vrit mendjen, vërtet.

Biondi tund kokën, pa kuptuar. Pastaj më përshëndet me një gjest të vogël, 205-a pa çati, fringo e re, vazhdon rrugën.

Pse të kthehem në shtëpi kaq shpejt?

Atëherë më mirë të kisha qëndruar me Alesion dhe Klaudion, kjo mundësi nuk do të më jepet më, liria për të shkuar ku të dua, pa orare, pa rregulla, apo kufizime të çfarëdollojshme. Meritën për këtë mundësi ma ka dhënë tezja, unë vetë nuk bëra asgjë. Iu deshën dhjetë vjet, por më në fund arriti ta bindë mamanë time. T'i kalonin pushimet bashkë, në shtëpinë e saj, shtëpi i thënçin, një godinë me parafabrikat që ka ndërtuar i shoqi pa leje, në rrethinat e Fondit. Ndërsa vëllai dhe motra janë me pushime me të dashurit e tyre, ajo në Kalabri, ai në Sardenjë.

Mamaja kishte pothuajse njëzet vjet pa bërë pushime. Si përfundim fituan zërat e atyre që e nxitnin të shkëputej për të pushuar, dhe ajo, pa shumë dëshirë, u dorëzua. Dy javë në plazh me të motrën. Në pesëmbëdhjetëditëshin e dytë të gushtit. Në shtëpinë e pushimeve tezja nuk ka telefon, në fakt nuk ka as ujë, për atë punë. Për herë të parë, unë dhe mami nuk do të shihem për dy javë të plota, nuk do të shkëmbejmë asnjë fjalë, as përqaftime, as buzëqeshje. Me ta marrë vesh lajmin, u hodha përpjetë si në stadium.

Ndjesinë e ndërpreu një teh akulli, që më përshkoi kryet nga veshi në vesh. Një ditë, mungesa e saj do të bëhet e përhershme. Unë do të rritem dhe mamaja nuk do të jetë më. Nuk kam mundur t'i shmangem më këtij përfytyrimi, më zbret përpara syve pa më lënë mundësinë për ta larguar. E shoh të vdekur. Teksa unë mbetem vetëm në botë. Nuk e di nëse do të mbijetoj pas vdekjes së nënës. Por, më pas, diçka ndryshon, një ndjenjë rebelimi lind brenda meje. Tek e fundit, kjo nevojë që kam pasur gjithmonë për të kuptuar buron nga kundërshtimi i atij përfytyrimi të mbrapshtë. Sepse unë nuk di si t'ia dorëzoj vdekjes mamamë time, një vdekjeje të përjetshme, një fundi ku nuk ka më tjetër vend që të mund ta presë. Të jetosh këtë përfytyrim është e tmerrshme, nuk e di pse e përjetoj pikërisht unë, por më duket sikur ndiej ftohtësinë e lëkurës së saj, të dorës së saj, e shoh të palëvizshme, të mbaruar. Përballë kësaj gjendjeje kam dy mundësi. Ose të dorëzohem ndaj këtij vizioni, ta pranoj në zemër atë vdekje pa kthim, ose të hidhem në gjëra të tjera, brenda njerëzve, duke kërkuar çdo gjë që mund të më japë ende frymëmarrje, një shpresë. Mundësinë për të kuptuar. Nuk dua asgjë tjetër nga jeta. Që ajo asgjë të mos jetë gjë tjetër veçse rezultati i një mendjeje që ka lindur e shtrembër. Mendja ime.

Gjithsesi, një përpjekje të fundit mamaja e bëri.

Për të, dy javë pa folur me të birin Ishte thjesht e papranueshme. Sidomos kur i biri është ende i mitur, si në rastin tim, ndërsa për motrën dhe vëllanë, që janë më të mëdhenj, e ka pranuar, edhe pse me pahir.

Atëherë rekrutoi për misionin e saj fqinjën. Unë e marr në telefon Marianën, kështu e quajnë, dhe i tregoj çfarë kam bërë, më shumë për ta qetësuar, pastaj ajo flet me mamanë, e cila qetësohet gjithashtu. Aq sa është e mundur. Duke e njohur, do të jetë duke jetuar në simbiozë të plotë me kabinën telefonike.

Mamaja mendonte se me këtë sistem do të kishte lajme nga unë çdo mbrëmje. Por e kuptoi shumë shpejt se bëhej fjalë për një sakrificë të papranueshme, sidomos për Marianën. Arritëm një kompromis të përsosur. Dy telefonata. E para u bë: dje. E njoftova që kisha mbërritur në Romanjë. E dyta të premten më datë 23, në orën 18:00. Pra pas një jave. Në gjysmën e pushimeve të mia, dhe të sajave.

Biseda në telefon me Marianën është mjaft e lehtë. Mund ta përballoj mirë, pavarësisht dashamirësisë së saj, nuk ka atë vigjilencën që kanë zakonisht prindërit për fëmijët e tyre. Nuk do të vërë re këtë ndryshim të lehtë në planin e pushimeve.

Të paktën kështu shpresoj.

Kam humbur sensin e kohës. Kënga e gjinkallave mbulon gjithçka, edhe të nxehtin, edhe etjen. Një tingull që kalon në çast nga melodia në zhurmë, kaq shumë e kam dëgjuar sa më duket sikur brenda ka edhe fjalë, dhe druaj mos më ka rënë dielli në kokë, apo diçka e ngjashme. Nata e kaluar duke kërcyer, gjithë ai alkool, pastaj figura e tmerrshme që bëra. Lodhja fillon të ndihet, një rraskapitje e përzier me dhimbje stomaku më godet me hope. Duhet të pi. Duhet të ha.

Përfytyrimi i ujit.

Gjunjët më këputen: çanta e zezë prej lëkure e Alesios.

Jo.

Duart shkojnë mbi fytyrë, mekanikisht.

S'ka mundësi.

Dje, sapo filluam pushimet së bashku, vendosëm t'i mblidhnim bashkë një pjesë të parave për shpenzimet e përbashkëta, dhe ia besuam pikërisht atij, Alesios, i vetmi që kishte patentë në treshen tonë, i vetmi që kishte një vend ku t'i mbante. Pikërisht çanta e zezë. Madje unë, për të qenë i qetë, i lashë edhe kartën e identitetit, nuk doja të rrezikoja ta humbisja, përveç pesëqind mijë liretave për ushqimin dhe argëtimet. Kampin e kishim paguar sapo arritëm. Treqind mijë lireta të çuara dëm.

Mbetem i përkulur mbi gjunjë. Me fytyrën e njomë nga djersa të shtrënguar mes pëllëmbëve të duarve.

Një ankth që nuk më lë të mbushem me frymë dhe që përzihet me rraskapitjen dhe dhimbjen e stomakut. Më pushton një frikë që nuk e kisha ndier kurrë më parë, çfarë të bëj tani? Kush do të më ndihmojë?

Jam qindra kilometra larg shtëpisë. Vetëm. Pa dokument. Dhe më keq, pa as edhe një qindarkë. Ngrihem me vrull, sytë ndjekin një iluzion. Volkswageni-i Alesios. Ndoshta e ka vënë re dhe po kthehet, unë nuk kam lëvizur nga vendi ku u ndamë.

Por shpresa shuhet shumë shpejt.

E largon sakaq etja.

Volkswagen-i i Alesios nuk u duk. Natyrisht.

E kam gojën aq të thatë dhe gjuhën e trashur sa nuk ma merrte mendja, etja është kthyer në dobësi, një gjendje e përgjithshme vuajtjeje që sa vjen e përkeqësohet.

Nuk mund ta përcaktoj prej sa kohësh jam këtu, duhet të ketë shkuar ora pesë e mbasdites.

Trafiku është shtuar pak, por gjithë mjeshtëria ime në autostop nuk dha rezultat. Herë pas here, me intervale të ngjashme me dhimbjen e stomakut, që po më mundon prej alkoolit të mbrëmshëm, ngjitet edhe shpresa se në horizont do të shfaqen edhe miqtë e mi. Në një çast madje shpresova edhe që të rishfaqej biondi me kabrioletin 205-sh. Po të mund të kthehesha pas, nuk e di nëse do të bëja gjithçka njësoj, por me siguri do t'i merrja Alesios paratë dhe letërnjoftimin. Vështirësinë për të gjetur një makinë që të ndalet të më marrë e kam lidhur me pamjen time sot. Nëse pamja përkon sado pak me vuajtjen që më ka kapur,

duhet të dukem copë-copë. Edhe unë, po të isha në vendin e udhëtarëve që më kalojnë pranë vetëtimthi, vështirë se do të më ndaloja.

Më në fund ndalet një makinë. Është një Volvo 240, makina që më pëlqen më shumë nga ato që kam parë në qarkullim. E re fringo. Edhe ngjyra është perfekte. Gri e errët, ose diçka e ngjashme.

Hap derën dhe një rrymë ajri e ftohtë, e panatyrshme, më zë të papërgatitur.

Në timon është një burrë rreth të pesëdhjetave, veshur me një pardesy bezhë, ndoshta për t'u mbrojtur nga kondicioneri që fryn pa mëshirë.

Më buzëqesh.

- Për ku je nisur?

- Për në Romë.

- Unë shkoj këtu afër, në Morçano, pak kilometra më poshtë, por gjithsesi në drejtimin e duhur, le të themi, por nëse do të presësh ndonjë që mund të të çojë më larg, nuk prish punë.

Si përgjigje, hipi në makinë. Nuk më bindi aq shumë destinacioni, të cilin as që e kam dëgjuar ndonjëherë, por mrekullia e ajrit të ftohtë që vjen nga makina.

- Shumë mirë.

Shpëtimtari im nis makinën, ndërsa unë pranoj ledhatimet e sediljeve prej lëkure, ngjyrë krem, akull të pastra.

- Do të të tregoj diçka, por mos u tremb.

Nuk ka mënyrë më të mirë për ta tmerruar dikë sesa t'i thuash diçka të tillë. Pak sekonda më parë

e konsideroja shpëtimtarin tim, tani më duket një përbindësh, veshur edhe me pardesy, më 16 gusht.

- Po organizoj një festë në pishinë në shtëpinë time dhe na mbaroi “Coca-Cola”, duhej të vishesha, por në fund vendosa të vishja vtëm një pjesë të kostumit, pak kilometra janë gjithsesi.

- Pohoj me kokë edhe pse nuk kuptova asnjë fjalë. Ndërkohë, bashkëudhëtari im lëshon timonin për të zgjidhur rripin e pardesysë. Tani ndiej tmerr të mirëfilltë.

- Organizova një festë me maska dhe jam veshur si maniak, ose diçka e ngjashme.

Duket shumë në vështirësi, nuk kisha parë ndonjëherë njeri aq në siklet, dhe kur hap pardesynë e kuptoj edhe arsyen. Poshtë ka veshur rroba banje femrash, trup, ngjyrë blu, me qimet e zeza që dalin nga gjoksi, supet, qafa.

- Vërtet, mos ki merak.

Pohoj me kokë, por tani më intereson të kuptoj diçka tjetër. Nën rrobat e banjës, nga pjesa e legenit del diçka gjigante, një lloj gypi që ngjitet deri poshtë sqetullës.

- Është një copë tubi për vaditje, duhet të duket si... e kupton vetë...

- Po, po, e kuptova.

Nuk e mbaj dot të qeshurën, qesh edhe ai pas meje. Sa e bukur është ndjesia që të pushton trupin pas një rreziku të shmangur, një lloj qetësuesi natyror, çfarë nuk do të jepja për ta pasur gjithmonë këtë ndjesi paqeje të pathyeshme brenda vetes.

- Unë quhem Enriko.

- Daniele.

- Paske marrë goxha rrugë, të kam pak zili.

Më në fund, dikush e mirëkupton vendimin tim. E shoh më mirë. Ka pak flokë dhe, nga afër, duket më i ri sesa mosha që i dhashë me mend pak më parë.

- Sa vjeç je?

- Tridhjetë e gjashtë, po ti?

Mendova më shumë, jo se tridhjetë e gjashtë vite janë pak, ai e vë re shikimin tim, duke u zbavitur.

- Shiko se do bëhesh kaq edhe ti, koha duket sikur nuk kalon kurrë deri në të njëzetat, pastaj bëhet e pandalshme, do ta shohësh.

- Ndoshta, por s'e imagjinoj dot veten të rritur, babi mbushi dyzet e nëntë vjeç muajin e kaluar, vitin tjetër bën pesëdhjetë, gjysmë shekulli, *m'ikën truni* kur e mendoj, gjithsesi, unë jam shtatëmbëdhjetë vjeç.

Enriko qesh me të madhe.

- Qenke fiks nga Roma, nga e folura.

Ngre supet, nuk më pëlqeu shumë komenti.

- Është problem?

- Tallesh? Dialekti i Romës më pëlqen shumë. Kisha një shok universiteti nga Bufalota, shkon në shkollë ti?

- Po, jam në gjimnaz t. Duhet të filloj vitin e dytë, jam një vit mbrapa, fatkeqësisht.

- Ke ngelur në klasë?

- Jo, pas nëntëvjeçares bëra njëzet e një ditë në një shkollë teknike industriale, sepse e kishte bërë edhe

vëllai, por e kuptova direkt që s'ishtë punë për mua dhe e lashë.

- E po, paske pasur guxim, dhe tek e fundit ke bërë mirë, nëse e kuptove që s'ishte shkolla e duhur për ty, jo të gjithë e kanë këtë forcë.

Nuk e di pse, por ajo që tha në fund sikur e trishtoi, të paktën ashtu më duket.

- Po ti me çfarë merresh?

- Jam pediatër, punoj në një spital këtu afër.

- Qëndrojmë në heshtje. Ndërkohë, mua m'u shfaq përpara syve doktoresha që më kuroi kur isha i vogël, në spitalin "Bambino Gesù", për një dizenteri shumë të rëndë. I mbaj mend fare mirë shokët e dhomës, të gjithë të vegjël si unë, sidomos njëri, kockë e lëkurë, i ligështuar nga sëmundja.

- Unë s'do ta bëja dot punën e pediatri, vetëm të rriturit duhet të sëmuren, fëmijët duhet të jenë gjithmonë të shëndetshëm dhe të lirë, siç thotë mamaja ime.

Enrikoja qëndron në heshtje, i përhumbur pas diçkaje që padyshim nuk e bën të lumtur.

- Kur ke një baba psikiatër dhe një mama kardiologe, nuk ka shumë rëndësi çfarë bën apo nuk bën dot, vendos tjetërkush.

Tani duket shumë më i madh se tridhjetë e gjashtë vitet e tij.

Palumturia të plak.

Volvo-ja ndalet përpara një porte me kangjella hekuri, nuk jam i zoti me përmasat dhe nuk jam në

gjendje të them sa e lartë apo e gjerë mund të jetë, por dyer kaq të mëdha i kam parë vetëm në televizor, duket si ato vilat e serialit “Dallas”, dhe tani do të shfaqet J.R.-i me kapelën e madhe teksane.

Çfarë gjendet pas derës tejkalon edhe imagjinatën. Nuk di si ta quaj shtëpinë e Enrikos. Vilë më duket pak. Është diçka më shumë, një bukuri që të lë pa fjalë. Ndërtesa kryesore është në ngjyrë rozë të lehtë, dritaret kanë një kornizë të bardhë, gjithçka duket sikur është llogaritur dhe rregulluar në mënyrë të përkryer në çdo vogëlsi. Edhe kopshti duket si i vizatuar, asnjë gjethe apo fije bari e tepërt.

- Ka qenë vila e pushimeve e një familjeje fisnikësh, gjyshi e bleu shumë vite më parë dhe e restauroi nga e para.

- E mrekullueshme.

Nuk arrij të them gjë tjetër.

I afrohem Enrikos për ta përshëndetur, ai mbërriti, ndërsa unë jam ende në fillim të udhëtimit tim, me të zbritur nga Volvo-ja e tij, kthehet edhe nxehtësia mbytëse dhe menjëherë më pas edhe etja.

Një siguri e qartë, e palëkundur, më del përpara syve. Dy javë udhëtim, derisa të përshkoj gjithë distancën që më ndan nga shtëpia, nuk kam rrugë tjetër. Më duket sikur një urdhër i ri hyjnor zbret nga qielli, dhe t’i bindem nuk është zgjedhje.

Do të më duhet të mësoj të kërkoj ndihmë.

Njerëzve që do të takoj, atyre që do të duan të më ndihmojnë. Sepse nuk mund të mbijetoj pa pirë, pa

ngrënë, dhe vetë unë nuk kam asnjë qindarkë. Edhe pse shkon kundër karakterit tim, edhe pse më vjen turp, nuk kam rrugë tjetër.

- Hajde të bësh një xhiro, po të kesh rroba banje mund të lahesh në pishinë.

Enrikoja paraprin çdo lëvizje timen, më kursen mundimin për t'i kërkuar diçka për të pirë apo për të ngrënë, por ankthi mbetet, bashkë me bindjen se nuk do të jetë gjithmonë kaq e lehtë.

- Nëse nuk shqetësoj.

- Hajde, mos e vrit mendjen.

Ndërsa ecim nëpër kopsht, më i madh se një fushë futbollit, përpara hyrjes, dalloj zërin e Lucio Dalla-s që bëhet gjithnjë e më i fortë. Kënga “Kujdes ujkun”. E adhuroj Lucio Dalla-n, por kjo këngë nuk është nga të preferuarat e mia. Nën zërin e Dalla-s fillojnë të dëgjohen qeshje, zëra të ndryshëm që flasin, më pas tingulli i qartë i një trupi që hidhet në ujë. Kur dalim në pjesën e pasme të vilës, më kaplon një reagim nervoz i pazakontë, filloj të qesh pa arsye. Enrikoja më shikon i habitur.

- Më fal, por diçka të tillë nuk e kisha parë ndonjëherë.

Sepse nëse hyrja dhe fasada e vilës janë të bukura dhe mbresëlënëse, pjesa e pasme është thjesht e pafundme. Pishina drejtkëndëshe dhe gjigante, menjëherë pas saj ka dy fusha tenisi krah njëra-tjetrës, më tej një fushë futbollit e vogël dhe në fund një vresht që shtrihet deri ku të zë syri. Enrikoja heq pardesynë

dhe mbetet me kostumin e banjës, të pajisur me atë bibilushin plastik gjigant, më pas më kap nga supi, më shoqëron në qendër të grupit të miqve të tij. Maskat e të tjerëve janë mëse të zakonshme: dy vajza me rroba havaiane, disa djem me rroba banje dypjesëshe. Unë do të kisha bërë diçka më interesante. Mes tyre, Enrikoja ka padyshim veshjen më argëtuese. Miqtë e tij, nga sa duket, kanë të gjithë të njëjtën moshë me të. Janë shtrirë në shezlongë dhe bëjnë banjë dielli, disa janë në ujë.

- Ky është Daniele, është shtatëmbëdhjetë vjeç dhe po bën diçka që unë e kam shumë zili: është nisur nga Mizanoja dhe do të kthehet deri në shtëpi me autostop, në Romë.

Disa brtima admirimi, veç shikimeve dhe buzëqeshjeve, më bëjnë të ndihem papritur më i gjatë dhe më i bukur.

- Dhe nuk ke frikë, - pyet një nga shoqet e Enrikos, ndërsa më shikon ngultas, nga koka te këmbët.

- Mjafton të bësh kujdes.

Nuk e di nëse është përshtypja ime, por më duket sikur më shohin të gjithë me një këmbëngulje të tepruar, madje përqëndrohen veçanërisht te atletet e bardha °Superga°, domethënë gri, falë mamit që i futi në lavatriçe me një kanotiere të errët të motrës. Edhe valixhja, kushedi për çfarë arsyeje, duket sikur u zgjon kureshtje të madhe.

- Me çfarë merresh?

- Studioj, jam në vit të dytë në gjimnaz.

Vazhdoj të ndihem nën vëzhgim të rreptë, si gjatë një seance pyetjeje të një hetimi në një serial policor.

- Po prindërit me se merren?

- Një krah kalon poshtë timit, është i Enrikos.

- Mos ua vër veshin, këta kanë për borxh të të pyesin edhe për rrogën e babit dhe të mamit, merr diçka për të pirë, duhet të ketë mbetur edhe ndonjë panine ose pak picë, nëse nuk i kanë mbaruar të gjitha kur ika unë.

Enrikoja më çon përpara një tavoline të gjatë, ku haptazi janë vendosur një sërë pjatancash të mbushura me gjithçka që nuk duhet të mungojë kurrë në një festë: panine me sallam, toste, pastaj edhe pica, pica të mrekullueshme, me dhe pa salcë. Së fundi, pije të të gjitha llojeve: në shishe dhe kana, birra, një enë e madhe me verë të kuqe dhe fruta.

- Merr ç'të duash.

Enrikoja kthehet te miqtë e tij. Unë përpiqem të përmbahem, të mos e lëshoj veten përpara gjithë atij bollëku. Më vjen ndër mend dita e kungimit tim, vetëm atëherë kam parë tavolinë të shtruar në atë mënyrë.

Zgjedh gotën më të madhe mbi tavolinë. Uji rrjedh i ftohtë dhe i gazuar nga buzët deri në fyt, duke ngrirë stomakun. Pi tri gota me një frymë, dhe pas çdo gllënjke përsëris të njëjtën gjë në mendje: Sa i mirë është uji. Thonë se nuk ka shije. Shkoni thuajani dikujt që ka etje.

Katër kafshata dhe copa e parë e parë i picës zhduket.

Më shfaqet pranë imazhi i mamasë që më thotë të ha ngadalë.

Kuptohet që nuk ia vë veshin. Dy sanduiçë zhduken po aq shpejt, të shoqëruar nga një gotë e gjysmë Fanta, fatkeqësisht e ngrohtë.

E kanë radhën ëmbëlsirat, ha biskota me marmalatë, pastaj pasta të vogla me krem. Pastaj kthehem sërish te biskotat me marmalatë.

Nuk e di sa kohë m'u desh, gjithsesi pak minuta, por kur largohem nga tavolina ndihem tjetër njeri. I ringjallur. Me energji. I kthjellët. Udhëtimin im, me barkun plot, e shoh më pak dramatik nga ç'më dukej përpara pak çastesh. Përkundrazi.

Ndihem i ngazëllyer, me një ndjesi kontrolli deri atëhere të panjohur mbi jetën time. Mund të bëj ç'të dua. Jam i lirë. Çdo zgjedhje është në duart e mia. Këto dy javë, jam i zoti i jetës sime. I rritur. Kush më pengon të bëj një banjë në pishinë? Askush. Dhe pikërisht këtë do të bëj.

- Nëse nuk të prish punë, po shkoj të vesh rrobat e banjës.

Enriko përgjigjet me një buzëqeshje kënaqësie.

- Futu brenda, banja e parë është në të djathtë, dera e tretë.

Me valixhen time të rëndë plumb të rëndë, hyj në vilë nga dera e madhe pranë pishinës.

Salloni është jashtëzakonisht i madh. E mendoj instinktivisht sapo arrij ta shikoj në tërësinë e tij. Mund të jetë të paktën pesë ose gjashtë herë më i madh se salloni i shtëpisë sime. Në njërën anë ka dy divanë

të mëdhenj me kënd, të vendosur përballë njëri-tjetrit krijojnë një lloj katrori, përpara një oxhaku më të lartë se unë, antik, të paktën dy metra i gjerë.

Një tjetër cep i sallonit mban një piano të mrekullueshme, pranë së cilës ngrihen dy bokse druri të çelur; pas tyre, një impant audio dhe një koleksion mbresëlënës disqesh. Pastaj vitrina, disa rafte librash dhe kudo piktura. Mbi gjithçka, mbizotëron një mirëqenie që e kisha parë vetëm në televizor, ose e kisha dëgjuar në përshkrimet e miqve, ose të disa të afërmeve.

Sytë më shkojnë te një mobilie e ulët prej druri të errët, mbi të cilën janë rreshtuar disa korniza argjendi, të gjitha me foto, disa bardhezi, të tjera me ngjyra. Afrohem. Te fotografuar në pozicione të ndryshme arrij të njoh familjen e Enrikos, si dhe atë vetë, ndër vite. Shikimi nuk i ka ndryshuar aspak, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për flokët dhe shprehjen e lumtur që kishte në rini.

Pranë tij qëndron gjithmonë një vajzë e vogël, më pas më e rritur, e cila duhet të jetë e motra, me gjasa disa vite më e vogël. Pranë tyre, prindërit. Babai, si i ri ashtu edhe në moshë, ka një shikim të vrenjtur në çdo fotografi, aristokratik. Nëna, në të kundërt, duket më e butë, jo pej shtatit, jo fort të imët, por nga shikimi, në sytë që përcjellin një ëmbëlsi që atyre të babait u mungon. Ama diçka tjetër më bën përshtypje më shumë se fytyrat. Mirëqenia e pranishme kudo, e shfaqur gjithmonë, në çdo fotografi, kjo më shqetëson, dhe ma ndryshon befas humorin.

Enrikoja dhe familja e tij kanë qenë gjithmonë kështu si tani, të pasur, kaq thjesht. Nuk u vë faj, madje as vetë nuk do të kisha jetuar ndryshe në vendin e tyre. Por nuk mund të mos ndiej në lëkurë një dallim të thellë mes meje dhe tyre. Nuk është çështje simpatie apo antipatie, por origjine, jete të jetuar. Sytë më ndalen te një fotografi bardhezi. Enrikoja fëmijë, i buzëqeshur, veshur si burrë i vogël, dhe në krah e ëma, po aq perfekte, pranë pemës së Krishtlindjeve. Nga kjo fotografi mori shkas gjithçka. Ma ndezi kujtesën duke më zhytur në të kaluarën time, në kërkim të një kujtimi për ta mbivendosur, dhe vizioni, i qartë si kristal, mbërriti.

Krishtlindjet e shumë viteve më parë. Një Babagjysh shumë i ri për të qenë i besueshëm, unë në krahët e tij, gjashtë vjeç, me buzëqeshjen e dikujt që ende beson gjithçka, pak më mbrapa edhe mamaja. Janë disa detaje, që në fakt nuk janë thjesht vogëlsi, që bëjnë dallimin. Unë kam veshur një palë pantallona të zgjatura të paktën katër herë, një pallto që kishte qenë e kushëririt tim, me një mëngë të arnuar, dhe këpucët e ngrëna te majat.

Por kjo brengë që ndiej nuk vjen nga mungesat që kam vuajtur, as nga traumat e fëmijërisë. Brenga ime ka një emër të saktë. Është e kotë të mundohem t'i shmangem.

Quhet ndjenë faji.

Sepse për herë të parë po dëshiroj me gjithë shpirt një jetë tjetër nga kjo e imja. Një mbiemër tjetër, një

tjetër histori pas krahëve, një shtëpi si kjo, dy prindër si ata të Enrikos.

Ndihem si tradhtar. I padenjë.

Sepe e di sa shumë gëzim ka kaluar brenda gjërave tona, mjaft modeste krahas këtyre, sa e lumtur ka qenë jeta jonë, dhe ashtu është edhe sot, brenda një shtëpie sa gjysma e sallonit të Enrikos. Dhe munda i atyre që bënë gjithçka të mundur, që nga momenti i ngjizjes e deri më sot. Babai dhe mamaja ime. Që asgjë nuk trashëguan nga prindërit e tyre, aq më pak një shtëpi si kjo, dhe që asgjë nuk do të lënë për ne fëmijët, veç rrugëtimit të dashurisë në këtë botë, një yll i vendosur më lart se gjithë të tjerët.

Ndjenja e fajit bie në gjunjë përballë nostalgjisë.

Tani vetëm mall kam në zemër, i pafundëm, një shpërthim që më pushton plotësisht, është një dhembje që e njoh mirë, si një egërsirë që ia ke frikën duke e ditur se nuk mund ta zbutësh.

Kushedi çfarë po bëjnë tani prindërit e mi.

Është hera e parë që jemi kaq larg, që nuk flasim, dhe nuk do të flasim gjatë gjithë kësaj kohe.

Mesigurimamidhetezjapobëjnëgatidarkën; babime xhaxhin në kopsht, duke folur për punë, ose për politikë. Shpresoj të pushojnë. Dhe të kujdesen për veten. Sidomos mami, nuk duhet të harrojë ilaçet për stomakun dhe pomadën për dermatitin. Babit i bëra fjalimin e zakonshëm: të hajë dhe të pijë më masë. Ialashësi porosi. Qëndroj si i ngrirë. Duke pritur që egërsirës,

nostalgjisë, t'i bjerë disi agresiviteti, dhe ta përfundojë
punën e vet si një përbindësh i pangopur.

Kjo dhimbje, dhimbja ime, është më e madhe se
unë.

Ka shekuj, mijëvjeçarë.

Nuk e di pse më ka zgjedhur mua.

Nuk mund të rri këtu.

Do të më më kaplonte përsëri ndjenja e fajit. Sepse mjafton të hedh sytë mbi diçka të bukur që nuk e kisha vënë re më parë që të më pushtojë sërish ai dëshirim i ndotë: të jem Enrikoja, me gjithçka që vjen nga pas. Por të ishte vetëm për ndjenjën e fajit edhe mund të bëhej. Problemi qëndron te ndjenja që vjen më pas.

Nostalgjia mund të të vrasë. Të paktën mua.

- Vajti vonë, më mirë të nisem unë.

Enrikoja po flet me një mikun e tij kur i dal përpara. Më shikon pa kuptuar, më studion duke menduar se po bëj shaka, pastaj e kupton që nuk është ashtu.

- Ndodhi ndonjë gjë? Më the që po shkoje të vishje rrobat e banjës.

- Ashtu thashë, po ndërrova mendje, më mirë të nisem. kam goxha rrugë, më mirë kështu.

Enrikoja largohet nga miku i tij dhe më afrohet shumë pranë.

- Mos të tha njeri ndonjë gjë dhe të mbeti hatri? Miqtë e mi mund të jenë shumë legena ndonjëherë, por nuk e kanë me të keq, janë si pulat në kafaz, njohin vetëm njëri-tjetrin dhe botën e tyre.

- Jo, pa merak. Thjesht kam frikë se nuk do më dalë koha ta bëj gjithë udhëtimin në aq ditë sa më kanë mbetur. Mamit do t'i bjerë pika po s'më pa në shtëpi në datë 31.

Enrikoja pohon me kokë, edhe pse është dukshëm i mërzhitur.

- Të shoqëroj unë deri te stacioni, po deshe, nuk është i lehtë ky udhëtimi që po bën, është normale nëse ke ndryshuar mendje.

- Jo, ç'thua? Vetëm më trego çfarë drejtimi të marr, nëse më ndihmon të orientohej, ta di për nder. Enrikoja ndalon të peshojë fjalët e mia, pastaj më kap për krahu.

- Hajde me mua.

Shkon te një miku i tij, i gjatë dhe i dobët, mbi gjoksin pothuajse pa qime ka pjesën e sipërme të një kostumi banje grash, ngjyrë rozë të ndezur.

- Ky është Pieroja, inxhinier për rastësi dhe shëtitës për pasion, më të mirë nuk gjen.

Ai, i përfshirë në bisedë në atë mënyrë, fryn gjoksin.

- Ti e di që Daniele do të kthehet në Romë me autostop, cilën rrugë ka më mbarë, sipas teje?

Gjatoshi përqendrohet sikur të ishte një ndonjë lojë televizive. Qëndron me sytë mbyllur, tejet i përqendruar.

- Atëherë...

Vendos një gisht mbi buzë, ndoshta për të menduar më mirë.

- Të nisemi nga një fakt. Autostopi është i ndaluar në autostradë, normale, si dhe në rrugë ndërqytetase, prandaj për mua rruga më e mirë është të kalosh nëpër qyteza, drejt jugut, drejt Umbrias, derisa të arrish në rrugën “Flaminia”, pastaj mbaron puna.

Enrikoja nuk duket i kënaqur.

- Domethënë? Konkretisht?

Pieroja psherëtin.

- Konkretisht duhet të kalojë nga qytezat e zonës, në Sant Anxhelo ose Urbania, pastaj të zbresë për në Gubio. Tani një fjalë goje është, po në këmbë janë ca kilometra.

- Po të duash, një copë rruge mund ta bëjmë bashkë, të çoj deri në Sasokorvaro, janë rreth tridhjetë kilometra, me makinë shkohet kollaj.

- Sigurisht.

Propozimi i Enrikos nuk mund të refuzohej, jo vetëm si një mundësi mjaft e mirë, por edhe për entuziazmin me të cilin po fliste.

Përsëendetja me të tjerët është mjaft e ngrohtë, jo siç do të ishte në botën time, por më mirë nga sa prisja. Një vajzë, në veçanti, më përqafoi shumë fort, aq sa më futi më mendje dyshimin se vendimi për të dalë me nxitim nga kjo situatë ndoshta nuk ishte zgjedhja më e mençur.

Por tashmë është vonë.

Kur hipim sërish në makinë, sytë më shkojnë tek ora e Volvo-s. Është ora tetë e darkës. Do të kisha thënë pak më vonë.

Ndërsa Enrikoja nxjerr makinën nga parkimi, sërish i mbështjellë me pardesynë që i mbulon kostumin, filloj ta shoh me një frikë disi çuditshme, një pyetje brenda meje bëhet gjithnjë e më këmbëngulëse. Pse po më ndihmon? Mund të vazhdonte festën që kishte organizuar dhe paguar vetë, si një mbret në pallatin e tij. Pse? Nuk arrij të gjej asnjë përgjigje që të mos jetë negative. Ndoshta i pëlqeva dhe pas pak do të tentojë ndonjë manovër me mua, apo ndoshta më keq, shumë më e keqe, ndoshta ai dhe shoqëria e tij janë një lloj sekt i që flizon të rinjtë në udhëtim e sipër. Do të doja ta pyesja, por zgjedh të rri në heshtje, duke ushqyer frikën time, gjithë dyshimet e mia.

Gjatë udhëtimit flasim pak, ia lëmë atë detyrë radios, me lajmet që njoftojnë për refugjatët shqiptarë që kanë zbarkuar në Bari, dymbëdhjetë mijë vetë mbi një anije të vetme. As unë dhe as Enrikoja nuk kemi shumë për të thënë, përveçse të përpiqemi me imagjinatë ta vendosim veten mes atyre mijëra qenieve njerëzore, të shtypur njëri me tjetrin, pa ujë, nën diellin e gushtit, në arrati nga vendi ku kanë lindur.

Kur mbërrijmë në Sasokorvaro, qielli e ka humbur dritën e ditës. Është ajo orë e mbrëmjeve verore kur gëzimi dhe melankolia bëhen një gjë e vetme.

Çfarë dhurate e mrekullueshme është vera.

Enrikoja ndalon makinën.

Përsëndetemi me një përqaftim.

Asnjëri prej nesh, deri katër orë më parë, nuk dinte gjë për ekzistencën e tjetrit.

- Bëj kujdes, mirë?

I përgjigjem me një ngërdheshje.

- Faleminderit për gjithçka.

- Faleminderit ty, ishe e vetmja gjë jo e zakonshme e ditës sime, pjesa tjetër ishte pasditeja e përhershme verore në shtëpinë time, me të njëjtat fytyra që shoh që kur kam qenë i vogël.

Pra, festa, pritja, nuk ishte një ngjarje e jashtëzakonshme, por një pasdite si gjithë të tjerat. Po kur duan të festojnë, çfarë bëjnë të pasurit?

Volvo-ja e Enrikos largohet.

Unë mbetem vetëm, brenda një nate të sapolindur, me valixhen timë të gjelbër. Doja të kërkoja një shishe ujë për ta marrë me vete, por në fund më erdhi shumë turp.

Ndjek një tabelë që tregon qendrën e qytezës, edhe pse është data 16 gusht, ka shumë pak njerëz përreth. Rruga është pak në ngjitje, dhe sapo marr një kthesë, përpara syve më hapet një pamje e papritur. Fshati shtrihet mbi një liqen; nuk është shumë i madh, por tani e ndezin ngjyrat e perëndimit. Rreth e rrotull, sa të zë syri, vetëm e gjelbra e pyjeve dhe ngjyrat e tokës me fushat e mbjella.

Bukuria ka rëndësinë e vet.

Ajo që tani më shpërthen në sy, spektakli i kësaj mbrëmjeje që shkon drejt përmbylljes brenda natës, bëhet ushqim për një pjesë të vetes sime që ende nuk e njoh, por që ekziston.

Nuk e di si. Por bukuria ka rëndësinë e vet.

Brenda çdo ngjyre të ndezur, në çdo rrahje qepallash që përtërin mahnitjen, ndiej diçka, si një emër që më kërkon ta gjej dhe ta shqiptoj.

Brenda bukurisë dikush banon.

Si quhesh?

Jemi vetëm unë dhe ti: dil jashtë.

Nuk do t'i tregoj askujt.

Përveç heshtjes, nuk vjen asnjë përgjigje.

Jo se kjo më habit, kam jetuar brenda pyetjeve të mia që kur isha një fëmijë që vuante pa e kuptuar përse. Ashtu si edhe sot.

Vazhdoj ecjen; ndërkohë, dita ka pushuar së ekzistuari.

Tani gjithçka është e errët dhe e pajetë. Një tabelë tregon drejtimin për në Roka Ubaldineska. Nuk e kam dëgjuar ndonjëherë, por atje po shkoj, me valixhen me vete.

I hedh një vështrim të fundit liqenit; tashmë është bërë i zi, si nata që e mbulon.

Kalaja e Sasokorvaros është madhështore. Tabela e llamarinës është zverdhur dhe zbehur nga koha, por është gjithsesi e lexueshme. Ndërtuar në vitin 1475. Gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore, njëfarë

Paskuale Rotondi fshehu atje rreth dhjetë mijë vepra arti nga nazistët, përfshirë punimet e Tiziano-s, Raffaello-s, Giorgione-s dhe Mantegna-s. Është një histori e bukur që nuk e njihja. Kalaja ka bazë rrethore dhe, gjithmonë sipas tabelës, brenda ndodhet edhe një teatër, i hapur për publikun, ndërtuar në mes të shekullit të 19-të.

Ky vend ka edhe diçka tjetër shumë të veçantë: një shesh të madh, të përshtatur si parking. Me siguri e kanë menduar për vizitorët e shumë. Tani është bosh.

Një cep i mbuluar, i fshehur nga një gardh me shkurre që shërben si kufi me një kopsht të vogël, është vendi që kam zgjedhur për natën time të parë të udhëtimit. Nata e parë jashtë. Në vetmi. Por nuk kam frikë. E gjithë zona është e ndriçuar mirë. Dhe bari është i thatë, ndoshta nuk ka shumë që e kanë prerë, dhe ka aromë të mirë. Nga valixhja nxora një triko, hapa peshqirin e plazhit që kisha me vete dhe u shtriva. Dhe tani ja ku jam.

Nuk kam para, as dokumente, por jam i qetë. Problemi i vetëm që mund të kem qëndron tjetërkund. Ndiej në trup një eufori që edhe gjysma do të mjaftonte për të ndriçuar një pallat. Një përzierje energjie, eksitimi dhe entuziazmi. Diçka e mrekullueshme, sikur të mos kisha nevojë për të pushuar. Ditët që më presin do të jenë padyshim të gjata dhe të lodhshme. Gjatë natës duhet të fle, përndryshe do të marr fund.

I jap urdhër vetes të fle.

Shtrihem, dhe pak më vonë strukem poshtë gardhit të ulët. Marr nga valixhja një palë pantallona të shkurtra dhe një bluzë. Ja ku e bëra edhe jastëkun.

Qëndroj në heshtje.

Por kjo vetëm sa e shton ndjesinë e zemrës sime që rreh me tërbim, pa ndonjë arsye të qartë. Ndiej në krahavor një altoparlant 5000 vatësh, si ato të “Cocoricò”-së një natë më parë. Vë re gjithashtu se po i mbaj nofullat e shtrënguara. Më shumë sesa një djalë gati për të marrë gjumë, dukem si një vrapues në vijën e nisjes, gati të shpërthejë pas shkrepjes së pistoletës.

Por duhet të fle.

Gjithë kjo nevojë për të fjetur, në vend që të më qetësojë, ma shumëfishon nervozizmin, një ankth që ushqen edhe më shumë zemrën e shfrenuar që kam në krahavor. Bukur shumë.

Mbyllsyte, çliroj pak morsën që më ka zënë nofullën. Kur frymëmarrja fillon të bëhet më e rregullt, ose të paktën më pak e rënduar, më trazon një motoçikletë e vogël që kalon me shpejtësi në shesh. Zhurma është e tmerrshme, një buçimë e fortë bezdisëse. Ua kam thënë gjithmonë shokëve që vënë dorë te marmitat, përse? Çfarë kënaqësie është të të urrejnë të gjithë? Përse duhet ajo zhurmë e padurueshme? Për shumë meshkuj duhet të ketë ndonjë lidhje mes zhurmës së shkarkimit të mjeteve të tyre motorike dhe vetëbesimit. Sa më shumë zhurmë bëjnë, aq më shumë ndihen burra. Një ditë do ta kuptoj edhe këtë.

Tani është kthyer qetësia, në largësi, dëgjohet një zë burri, por jo aq qartë sa të kuptohet. Ndoshta është televizori i ndonjë shtëpie këtu afër.

Filloj gjithçka nga e para.

Të mbyll sytë. Të kujtohem të çliroj nofullën. Të mendoj diçka të këndshme, por jo shumë angazhuese. Dhe të shpresoj që gjumi të më nderojë me praninë e tij.

Agimi zbeh ngadalë yjet në qiell.

Mbërrin kështu një ditë e re. Sapo fillon të shfaqet e kaltra, e ndiej se jam bërë tifoz i diellit që lind pas natës që sapo kalova.

Duhet bërë gjithmonë kujdes me gjërat e ëndërruara, por të papërjetuara ndonjëherë. Po ashtu, nuk duhet t'u zëmë besë të tjerëve, edhe kur janë miqtë tanë më të mirë.

Kam dëgjuar histori të hatashme për net të kaluara jashtë, pa as edhe një problem, gjithçka shkon vaj, si në filma.

Mbase.

Nata ime jashtë ishte një katastrofë.

Përveç gjumit, që nuk ishte gjumë i mirëfilltë, por diçka mes të fjeturit dhe zgjimit, si i një kafshe gjithmonë në gatishmëri, asnjë nga rrëfimet që kisha dëgjuar nuk kishte përmendur qoftë edhe një fjalë për disa problematika të vogla që duhen pasur parasysh kur e kalon natën nën yje.

Lagështira. Nuk e di çfarë ore mund të ketë qenë, por në një moment, trikoja, peshqiri i plazhit, madje edhe unë vetë, u mbuluam me një shtresë vese të ftohtë si ujë burimi. Dhe akoma jam disi i lagësht, pa përmendur një rëndesë në kokë dhe të ftohtin në eshtra që nuk po largohet.

Mushkonjat. Ndoshta vendimi për t'u strehuar nën një kaçubë nuk ishte më i mençuri. Jam mbushur me pickime, kudo, madje edhe nën xhinse, ndërsa më keq janë kyçet e këmbëve.

Kjo natë e tmerrshme shton edhe një problem tjetër, përpos gjithë gjërave që nuk kisha marrë parasysh në fillim të udhëtimit tim. Do të duhet të kërkoj ndihmë jo vetëm për të pirë e për të ngrënë, por edhe për të fjetur. Kështu nuk arrij të pushoj me të vërtetë dhe për më tepër rrezikoj të marr ndonjë pneumoni. Por një gjë është të lypësh ca para për një copë bukë dhe një shishe ujë, tjetër gjë është të gjesh një vend për të fjetur. Është një kërkesë më e madhe. Nuk e di nëse prindërit e mi, të afërmit apo të njohurit e mi do t'i ofronin një shtrat për të fjetur një djali të panjohur.

Teksa mbledh gjërat e mia, një zë gjithnjë e më këmbëngulës gjen vend në mendimet e mia.

Mos kam bërë një budallallëk?!

Vendimi im, gjithë ky udhëtim, është një aventurë fëmijërore që rrezikon të bëhet e rrezikshme. Dhe për çfarë? A besoj vërtet se do të arrij të kuptoj më shumë se ajo që ndiej dhe shoh? Çfarë mund të më japin këto dy javë? Çfarë shpjegimesh mendoj se mund të gjej?

Liqeni poshtë Sakokorvaros, teksa zbres ngadalë nga qendra e qytezës, ndriçohet sërish nga bukuria dhe e kaltra, duhet të jetë ora gjashtë, ndoshta diçka më shumë, pamja që hapet përpara syve të mi është një mrekulli e natyrës deri në horizont, një varg i vazhdueshëm kodrinash dhe butësi ngjyrash, e gjelbra e theksuar e pyjeve përshkohet nga rrugë të braktisura, qetësisht.

Gjithë pesimizmi, si vesa mbi bluzë dhe xhinse, zhduket sapo dielli bëhet më i ngrohtë. Edhe unë vetë gjej sërish euforinë e disa orëve më parë, entuziazmi më rreh sërish në gjoks.

Duhet të tregohem i kujdesshëm, sigurisht, por me frymën e duhur dhe pak fat, çdo gjë do të shkojë mirë. Si nata që sapo kalova.

Tek e fundit, a nuk janë pikërisht vështirësitë që e bëjnë të bukur çdo sfidë? Tani duhet ta lë mënjanë turpin dhe të kërkoj ndihmë kur të jetë e nevojshme. Ndërkohë, një tabelë më ofron emrin e liqenit nën Sasokorvaro: Merkatale.

Përsëritet nga larg Kalanë e Ubaldineskës, e rrumbullakosur si një zonjë me oreks të mirë, pastaj gjithë qytezën, dhe më në fund liqenin, që tani pasqyron pemët e shumta që e rrethojnë.

Nuk dua të kthehem në shtëpi. Të paktën deri kur sytë të më thonë “mjaf”, të përmbushur nga ky spektakël i botës që vdes dhe rilind çdo ditë.

Nuk mbetet gjë tjetër veçse të vazhdoj rrugën.

Ecja u bën kaq mirë mendimeve.

Mesatarisht, një njeri përshkon katër kilometra në orë, me hap të rregullt. Këtë informacion ia detyroj Renato Bagaljinit, trajnerit të fundit të karrierës sime si futbollist, e ndërprerë vitin e kaluar, kur ende nuk kisha mbushur gjashtëmbëdhjetë, për mungesë të dukshme talenti. Nuk e di nëse informacioni është i saktë, as kam mundësi ta verifikoj duke qenë se nuk kam orë me vete, por e di me siguri se për momentin nuk kam zgjidhje tjetër veçse të eci. Rruga ka kthesa të vazhdueshme dhe nuk më jep mundësinë të bëj autostop. Ose “të bëj gisht”. Megjithëse zakonisht në periferinë ku jetoj them “me bo gisht”. Tani tingëllon siç duhet.

Ngadalë, i nxehti fillon të ndihet përsëri. Me të, kthehet edhe etja, por më shumë se çdo gjë tjetër më mundon pesha e valixhes. Arrij në një përfundim të pashmangshëm: një pjesë të përmbajtjes së saj duhet ta hedh. Do të mbaj dy trikot e pambukut, ndonjë bluzë, pjesa tjetër, duke filluar nga rrobat e banjës, do të përfundojë në kazanin e plehrave. Është një zgjedhje e dhimbshme, një palë pantallona të shkurtra për në plazh sapo i kisha blerë, por kështu nuk vazhdohet.

Arrij në një kryqëzim. Nga njëra anë, tabela drejt Kazininës, nga ana tjetër drejt Urbinos. Miku i Enrikos më sugjeroi të merrja për në Urbino apo në Urbania? Qëndroj pa lëvizur në cepin e kryqëzimit, me njërën dorë shtrëngoj tëmthat, në përpjekje për ta kthyer kujtimin sa më të qartë dhe të kthjellët. Por është e kotë. Në fund, zgjedh drejtimin për Urbino.

Urbino dhe Urbania si emra janë të ngjashëm, nuk mund të jenë shumë larg njëri-tjetrit. Arsyetimi është krejtësisht debil, kaq sa pothuajse më vjen turp nga vetja, por nuk kam zgjidhje tjetër veçse t'i besoj intuitës.

Një prani e heshtur. Jo më larg se tre metra, fshehur nën pemët që gjelbërojnë rrugën e makinave, një mace që e ka ndjekur nga afër gjithë arsyetimin tim të çuditshëm. Shikojmë njëri-tjetrin. Është mace rruge, bukurinë ia ka vënë në provë jeta e vështirë, ngjyra gri në disa pika është më e errët, e pistë. Veshit të djathtë, në majë, i mungon një copëz, duket si kafshimi i një kafshe tjetër.

Vazhdojmë të shohim njëri-tjetrin.

Unë në diell, i djersitur, i etur.

Macja në hije, e qetë, siç dinë të jenë vetëm macet, qëndron kaq pa lëvizur sa nuk duket e vërtetë, asnjë lëvizje, madje as më e vogla.

Kam pasur gjithmonë ndjesinë se në sytë e kafshëve, disa shikime, si për shembull ky që po më ofron kjo mace rruge, përçojnë një dëshirë të madhe për të komunikuar, brenda pamundësisë për t'u shprehur.

E kam prej vitesh këtë siguri, dhe e mbaj për vete. Kafshët dinë.

Për këtë arsye nuk flasim.

Për këtë arsye Zoti ua ka hequr fjalën.

Në fillim flisnin si ne, qeniet njerëzore, por ndryshe nga ne, falë syve të tyre të mprehtë si tehu i shpatës, nuk u mbetej mister pa zbuluar.

Për këtë arsye tani janë memecë. Si kjo mace që më shikon me ngulm, që shumë gjëra, e ndiej, do të donte të m'i thoshte. Kush e di se për çfarë. Kush e di se për kë.

Pasi eca të paktën dy orë, duke bërë pra tetë kilometra, sipas përlogartijes së zotit Bagaljini, rruga më në fund u qetësua. Tani është një vijë e drejtë, ideale për të bërë autostop.

Dielli është lart, në kulmin e tij, do të jetë mesditë, ndoshta diçka më shumë ose më pak.

Përsëritet problemi i djeshëm.

Mund të jesh edhe Maradona i autostopit, por pa fushë futbollit dhe pa top nuk luhet. Dhe këtu nuk kalon asnjë makinë.

Ulem mbi valixhe, i dëshpëruar, gati për t'u hedhur në këmbë sapo të kalojë ndonjë makinë, por në horizont nuk duket asgjë.

Gjithsesi, Maradona-n nuk e fal. Kur ma tha babai, nuk më besohej. Jo për shpërdorimin e talentit apo për futbollin në vetvete, por për vogëlsinë e sjelljes, një i përzgjedhur që thith kokainë si një njeri i çfarëdoshëm. Që shkatërron jetën dhe karrierën për shkak të një vesi të rëndomtë. Si është e mundur që një madhështi e tillë të përfundojë ashtu? Një si Maradona duhej të thithë pluhur ari. Kurrsesi kokainë.

Shumë njerëz e paguajnë shtrenjtë origjinën që kanë.

Ky është përfundimi ku arritëm me babin, të mbështetur nga shumë histori të tjera shumë më pranë nesh sesa ajo e Maradona-s. Nëse vjen nga poshtë, nëse ke qenë njësh me tokën, duhet të qëndrosh gjithmonë në gatishmëri, sepse rrënjët e tua mund të të kërkojnë llogari një ditë, sidomos kur përpiqesh t'i çrrënjosësh nga jeta jote. Atëherë rebelohen, bëhen më të egra.

Cilado qoftë arsyeja, duhet të jemi krenarë për origjinën tonë. Ky ishte përfundimi i babait tim.

E bukur dhe e lehtë për t'u thënë, por jashtëzakonisht e vështirë, në mos e pamundur, për t'u bërë.

Të paktën kur je shtatëmbëdhjetë vjeç dhe jeton në një botë ku pasuria dhe shfaqja e saj është e vetmja urdhëresë që ka vërtet rëndësi. Atëherë aktron. Shtiresh. Ose e fsheh atë që je vërtet. Vishesh si dikush tjetër. Fjalë për fjalë. Nga këpucët te xhinset, te xhaketa, marka mbi marka për të treguar se jemi në anën e duhur të botës, kemi kartën që na lejon të hyjmë kudo, dhe që të tjerët nuk e kanë. Por brenda mbetemi ata që jemi, ende të lidhur me rrënjët tona, dhe ato marka me të cilat përpiqemi të ngrihemi në një nivel tjetër nuk janë asgjë më shumë dhe asgjë më pak sesa një kostum karnavalesh. Kostumi i një djali të pasur, madje shumë të pasur, që mund t'ia lejojë vetes të qëndrojë pranë njerëzve të tjerë si ai. Gjithsesi, Maradona-n nuk e fal.

Nga larg duket një pikë që afrohet, një makinë vjen drejt meje, ngadalë. Duket si skena e ndonjë filmi *western*. Një duel i shoqëruar nga zukama e bulkthave. Është një Fiat 126, i bardhë, që ecën pothuajse me hap njeriu. Dhe duket sikur nuk ka ndërmend të ndalojë. Unë, nga ana tjetër, jam gati të bëj gjithçka që të më marrë.

Kutiçka e bardhë ndalon. Nuk besoj se kishte mundësi tjetër, kisha dalë praktikisht në mes të rrugës. Më shumë sesa autostop, i bëra postbllok.

Në timon është një zonjë, e moshuar, flokët e thinjur të tërhequr pas dhe të kapur bisht, pavarësisht vapës, udhëton me xhamat e mbyllur, vetëm mbrojtëset e erës i ka lënë të hapura. Nuk bën asgjë për ta fshehur bezdinë që i shkakton kjo situatë. Zgjatet nga ana ime, por nuk bën zë, vazhdon të më vëzhgojë me sy të “armatosur”, ndërsa unë përpiqem t’i jap sadopak rëndësi vetes, shpalos një buzëqeshje që në të vërtetë

nuk ka asgjë të hareshme, nuk dua ta përfytyroj pamjen time në këtë çast.

- E di sa e rrezikshme është kjo që po bën?

Pohoj me kokë, serioz, i hidhëruar.

- E di, por kam orë që pres në rrugë, makina nuk po kalojnë, dhe po më bie dielli në kokë. Vërtet.

I mëshoj instinktit të nënës.

Jep rezultat. Gjithmonë.

Zonja e ul dhe zbut shikimin, tani duket shumë e ëmbël.

- Po është data 17 gusht, mor bir, nuk e dije që bënte vapë? Pastaj ç'është ky lloj udhëtimi kështu, Është me rrezik. Pse ke dalë në mes të rrugës?

- Është një histori e gjatë, por unë udhëtoj shpesh kështu. Bëj shumë kujdes.

- Mund të të çoj afër Urbinos, por ta dish që eci shumë ngadalë dhe nuk mund t'i ul xhamat se kam frikë nga insektet, ka shumë në këtë rrugë.

- Mrekulli, shumë faleminderit!

Kam urryer shumë gjëra dhe shumë njerëz në jetën time, por asgjë dhe askënd më shumë se valixhen time në këtë moment. Më nevojitet një përpjekje e jashtëzakonshme për ta vënë mbi sediljen e pasme të 126-s, me zonjën që më shikon gjithmonë e më e habitur.

Por në fund, me njëfarë dhune, më se e nevojshme në këtë rast, arrij ta fus brenda.

Sapo tërheq derën, vë re që rrallë herë kam ndierë nxehtësi të tillë, madje kurrë më parë. Në makinën që

duket sikur ka dalë nga bota e Pufëve mund të jetë edhe 50 gradë. Në radio transmetojnë një reklamë për një dyqan mishi të zonës, ku pulat e gjalla kushtojnë më pak se të therurat, diçka tërësisht e pakuptueshme.

- Më quajnë Daniele, shumë faleminderit.

Mirësjellja mbi të gjitha.

- Anamaria.

Zonja ma tha emrin pa ia ndarë sytë xhamit të përparmë, sikur të ishte një pilote e Formula 1 në mes të garës. Edhe nga mënyra si e mban timonin duket sikur po ecën me 200 kilometra në orë, kur në të vërtetë jemi me 40, kilometrazhi nuk gënjen.

- Nga Urbino je?

- Jo, nga Kastelli Romani, atje po shkoj.

Pa ia ndarë sytë rrugës, Anamaria bën një lëvizje të çuditshme të kokës dhe qafës, sikur t'i duhej të gëlltiste informacionin që i dhashë.

- Kështu ke ndërmend ta bësh gjithë atë rrugë?

E ka të pamundur të mos i kthejë sytë nga unë, për një çast e largon shikimin nga xhami, vështrimi shpreh më së shumti habi.

- E dinë prindërit? Nuk është diçka normale kjo që po bën, je i vogël, bota është e ligë. Teksa flet e shtrëngon timonin fort, edhe pse më shumë se një makinë duket sikur po drejton një anije në mes të stuhisë.

- E dinë, sigurisht. Në fillim ishin të shqetësuar, por tani janë të qetë.

Qëndrojnë në pritje, duke shpresuar që gënjeshtra të pranohet pa kundërshtim. Fatmirësisht, Anamaria është shumë e përqendruar te drejtimi i makinës. Mundohet të më shohë për herë të dytë, gjë që do të më vinte mjaft në vështirësi, por në rrugën tonë kanë filluar sërish kthesa të njëpasnjëshme, më mirë kështu. Ndërkohë, një dallim midis meje dhe saj më lë pa fjalë. Në atë nxehtësi të padurueshme brenda makinës, djersitja ime ka arritur nivele të panjohura më parë, duket sikur sapo kam bërë dush me gjithë rroba. Nga ana tjetër, zonja Anamaria, nuk djersin. Nuk ka as edhe një pikë të vetme djerse. Mundohem ta shoh më mirë, afrohem aq sa mundem. Asgjë. Është e freskët si një gonxhe trëndafili.

- Jeni besimtarë në familje?

Tani kam nevojë unë që t'i gëlltis fjalët. Nuk kam një përgjigje të prerë. Në shtëpi nuk flitet për Zotin, nuk ka rite fetare. Në kishë shkojmë vetëm për dasma dhe funerale, madje me njëfarë përmbajtjeje.

- Po, mjaftueshëm. Unë kam bërë pagëzimin, kungimin.

- Po krezmimin? E ke marrë ?

Anamaria i shkëput sytë nga xhami, as lajmi i udhëtimit tim të gjatë me autostop nuk e kishte tronditur kaq shumë. Pret përgjigjen time.

Do të doja t'i thosha që e kam bërë, por më pas mund të më pyesë për ndonjë hollësi? Çfarë t'i them? Ndihem sikur kam përfunduar në një provim latinishteje.

- Jo, për fat të keq.

Ajo i kthen sërish sytë te rruga, por pakënaqësia që ndien mbush hapësirën e vogël brenda Fiat-it. Herë pas here tund kokën, nuk i besohet.

- Krezmimi është thelbësor, është konfirmimi, është sakramenti që përforcon bashkimin me Krishtin. Është e lënduar, me të vërtetë.

- Shiko se do ta bëj, nuk diskutohet.

Anamaria shpejton papritur, duket sikur e ka kapluar një furi e befasishme. Më shikon për një çast, me ashpërsi.

- Ta pret mendja që do ta bësh.

Përgjigjja më bën të ndihem keq. Jo aq për veten, sesa për prindërit. Ata nuk u kushtojnë rëndësi këtyre formaliteteve, ndoshta pikërisht kjo më bën t'i adhuroj, bashkë me gjithçka tjetër. Por më pas atë ndjesi e zhvendos vetëm tek vetja ime, jo mbi dikë tjetër.

Do të doja të kisha guximin t'i tregoja Anamarisë se çfarë është Zoti në jetën time. Jo vetë Ai, por dëshira për Të. Do të doja që të ndiente çfarë kam brenda vetes. T'ia hiqja dorën nga timoni dhe t'ia vendosja mbi kraharorin tim. T'i thosha pa turp: "Mua më duket sikur brenda vetes kam një qen që ka humbur të zotin, me atë mallin që ndien kur kujton se kanë jetuar bashkë. Dhe që e kërkon kudo. Në disa momente aroma e të zotit bëhet më e fortë, atëherë gjithçka shndërrohet në një prani dashurie, por janë

thjesht disa vetëtima, djegie drite, në ato çaste shoh dorën që ka mbjellë pemët.

Por Anamarisë nuk do t'i thoja gjë prej gjëje. Diçka tjetër po ma më rëndon frymëmarrjen.

Nëse në këto çaste po lutem, nëse po shikoj tavanin e Fiat-it duke përsëritur fjalë në mendjen time, nuk ka të bëjë me Anamarinë, por me frikën se ky mund të jetë një iluzion.

O Zot, të lutem, mos ma bëj padrejtësinë të mos ekzistosh.

Nga radioja fillon të dëgjohet zëri i Riccardo Coccianti-s. “Se stiamo insieme”. E bukur është si këngë. po kanë muaj që e vënë kudo, e kam mësuar përmendësh, dhe pastaj më mbetet në kokë me orë të tëra.

- Anamaria, a mund të të kërkoj një nder? Mund të kërkoj një stacion tjetër? Kjo kënga është e bukur, por s'e duroj dot më.

- Shtyp butonin me numrin 2, fillon Rruzarja tani.
Ma dha urdhrin pa ia ndarë sytë rrugës.
Bindem.

Pamja e Urbinos më zë në befasi.

Më bën të vendos dorën mbi gojë.

Një oborr mbretëror i ngritur mes së gjelbrës së kodrave, me rozën e ndezur të tullave dhe diellin përvëlues, dhe mbi gjithçka ngrihen një kupolë dhe një kambanore, pranë një pallati me dy kulla dhe një lozhe qendrore prej mermeri të bardhë, madhështore, me shumë kate.

- Ai është Pallati Dukat.

Anamaria ka ndjekur shikimin tim, buzëqesh sikur pallati të ishte i saji, ose i ndonjë të afërmi.

- Nga kjo rrugë duket ana më e bukur, Fasada e projektuar nga Torricini. Por kjo nuk është asgjë, duhet ta shohësh nga brenda.

Idilin e ndërpret rënkimi i stomakut tim. Bosh. Uria dhe etja më kthejnë në realitet, duhet të jetë orar dreke.

- Unë pothuajse arrita, po të lë te kryqëzimi, nga këtu mund të shkosh drejt Urbanias ose Akualanjës, besoj se e ke parasysh.

- Sigurisht.

Ngre supet si për të theksuar përgjigjen, por në të vërtetë nuk e kam të qartë rrugën që duhet të ndjek.

Fiat-i ndalon.

- Bëj kujdes, do të të kujtoj sonte në lutjen e mbrëmjes, do të të duhet pak ndihmë.

Më shikon me ndjenja të ndryshme, të vendosura njëra mbi tjetrën, bezdia për mungesën e krezmimit ende nuk i ka kaluar plotësisht, por ka edhe dhembshuri.

- Faleminderit.

Hap derën për të zbritur. Në të vërtetë, ndodhem mbi një trampolinë dhe ka ardhur çasti të hidhem. Nëse duhet të mësoj të kërkoj ndihmë, ky është momenti. Kam uri dhe etje, dhe nuk kam asgjë për t'i plotësuar nevojat e mia. Është e lehtë për t'u thënë, por tmerrësisht e vështirë për t'u bërë.

- Anamaria.

Frymëmarrja më tradhton. Më merret fryma. Më duket sikur po bëj një deklaratë dashurie, stërmunduese.

- Unë. Do të kisha...

Ajo më vështron, gjithmonë e freskët si trëndafil, ndërsa mua, mes turpit dhe vapës, djersa nuk më ka kursyer as edhe një pjesë të trupit.

O tani o kurrë.

- Unë kisha nevojë, po, kam nevojë për një vend ku të ha dhe të fle, për sonte, domethënë, fatkeqësisht i kam bërë gabim llogaritë me paratë, nesër do të shkoj

në Gubio sepse kam xhaxhain që banon aty, mami i ka thënë të më japë njëqind mijë lireta.

Zhytja përfundoi, nga thellësitë e ujit sapo kam dalë në sipërfaqe dhe pres tabelën e gjyqtarit që do të më japë një vlerësim për performancën.

Anamaria nuk e priste.

- Nuk e di...

Tani belbëzon Anamaria. Nuk gjen fjalët. Vura në vështirësi një grua të moshuar. Më vjen keq, sinqerisht, por nuk kisha ç'të bëja tjetër.

- E ngrëna nuk është problem.

Nxjerr një tjetër grumbull fjalësh.

- Ndërsa për të fjetur... e kam me merak, të them të drejtën.

Sikleti i Anamarisë më djeg mua më shumë.

- Sigurisht, mos u shqetësoni, edhe sa për të ngrënë është mëse e mjaftueshme.

Papritur e përshkon një ndriçim i brendshëm, për herë të parë e shoh të buzëqeshë.

Në shtëpi e kam me merak, ama kam kotecin e pulave, ana ku mbaja lepujt tani është bosh, një dhomë e vogël është, por mund të flesh atje, ty të nxë, po të duash e pastrojmë pak dhe e rregullojmë.

Tani buzëqeshja e Anamarisë është edhe e imja.

- Shumë mirë.

Anamaria fut marshin dhe rikthehet në timonin e anijes së vet.

- Unë banoj poshtë qendrës.

Fiat-i ndjek një rrugë që rrethon gjithë qytetin e Urbinos, i cili qëndron më lart sesa rruga që të çon atje. Bukuria më mpin duart, më mbush me një zemërim të papritur. Shekuj më parë, pa mjetet e përparuara që kemi sot, njeriu ndërtonte madhështi të tilla, ndërmernte vepra të pamendueshme, duke e ditur mirë se vdekja do të vinte përpara se vepra të ishte përfunduar, një punë që do ta vazhdonte brezi pasardhës, shpesh edhe ai i vetëdijshëm se nuk do ta vendoste gurin e fundit. Pse? Çfarë i nxiste? Të viheshin në shërbim të një veprë, ta bënë më të rëndësishme se vetë jetën e tyre. Por, mbi të gjitha, çfarë ndodhi? Pse sot nuk ekziston më kjo dëshirë për bukurinë, një dëshirë aq e fuqishme sa të mposhtë edhe vdekjen?

Fiat-i i Anamarisë ndalon përpara një porte të gjelbër.

Pas saj, e bardhë, e vogël, dallohet shtëpia. Nuk ka çati, ndoshta ishte parashikuar të ngrihej edhe kati i dytë që nuk u bë kurrë.

Po ta shikosh mirë, duket e sajuar si tullat e lojërave me ndërtim.

- I ke qejf domatet?

Anamaria hap grilat e kuzhinës, unë pohoj me kokë, me dritë mund ta shoh më mirë shtëpinë e saj. Ose të paktën një pjesë të mirë. Kuzhina dhe dhoma e ndenjjes janë në një ambient, ka shumë hapësirë,

nga ku hapen tre dyer: dhoma e gjumit, banja dhe një dhomë tjetër me një makinë qepëse në mes, përreth saj, rafte metalike plot me rroba dhe metrazhe. Më tej xhaketa, pantallona, hedhur mbi varëset e shumta nëpër mure.

- Jeni rrobaqepëse?

- Po, këtë punë kam bërë gjithë jetën. Na e mësoi nëna, mua dhe motrës sime.

Një psherëtimë ia shoqëron fjalët. Shprehja që vijon është dhimbje të pastër, kaq e fortë sa është e pamundur për t'u fshehur.

- Nuk jeton më?

- Jo, jo, gjallë është, madje është më e re se unë. Jeton në anën tjetër të qytetit, ama nuk flasim prej vitesh. Edhe kur ishim të vogla, ishim ndryshe nga njëra-tjetra. Thotë që jam shumë e ashpër, shumë e ngurtë, por unë vetëm kështu di të jetoj.

Ndërkohë ka nxjerrë nga frigoriferi dy domate. Mbi kokë, varur në mur, mbizotëron piktura e Shën Mërisë, duhet të jetë riprodhim i ndonjë vepre të njohur. Poshtë saj, Anamaria ka fiksuar me gozhda një rruzare të madhe prej druri, rruazat janë pothuajse sa një arrë.

- Është Shën Mëria e Rafaelit, këtu në Urbino kemi shtëpinë ku ka jetuar dhe punuar. Ka mbetur edhe guri ku përgatiste bojërat me të atin. Dy fëmijët që shikon pranë këmbëve të Shën Mërisë janë Jezusi dhe Shën Gjoni.

Shën Mëria i vështron të dy fëmijët me buzët lehtësisht të tendosura në një buzëqeshje që shpreh mirësi të pastër. Jezusi merr nga duart e Shën Gjorit një kryq, gati si të ishte një lojë, pa e ditur se ai kryq do të jetë fati i tij. Por hiri që përshkon pikturën arrin të të qetësojë dhe lehtësojë shpirtin.

- Banja është atje, merr një peshqir te dollapi poshtë lavamanit, kush e di sa je djersitur gjatë rrugës.

Do të doja t'i thoja se jemi njerëz të gjallë dhe është normale të djersijmë, nuk jemi të gjithë si ajo, që duket sikur i përket një race tjetër, të përzier me zvarranikët. Si përfundim, e zbatoj urdhrin pa bërë zë.

Edhe në banjë nuk mungojnë elementet e shenjta. Një kryq hekuri, më pak i hijshëm se piktura, shumë më pak. Ndërsa lahem, nuk mund të mos i vë re sendet e vogla që shoqërojnë jetën e Anamarisë. Furça dhe pasta e dhëmbëve, një krem duarsh, një kuti e vogël e hapur me kremra të tjera, një shishe me parfum, disavjeçare. Më mbush sytë një ndjenjë dashamirësie dhe turpi, kureshtja kërkon të më nxitë të zbuloj më shumë, por arrij ta përmbaj. Tek e fundit, çdo njeri, Anamaria apo kushdo tjetër, mund të përmblihet në një grusht objektesh të përditshme. Sikur të mos mjaftonte gjaku, trupi, zemra, edhe gjërat e thjeshta që na duhen për të jetuar na kujtojnë se jemi të gjithë njëllë, kemi të njëjtat nevoja, të njëjtat zakone dhe të njëjtin fat. E njëjtë është edhe koha që rrjedh mbi ne, që i bën fëmijët të rriten dhe të rriturit të plaken.

Njerëzimi është një i vetëm, dhe ajo që na ndan do të mbetet gjithmonë e papërfillshme krahasuar me gjithçka që na bashkon.

Dal nga banja, i pastër dhe i parfumosur.

Ndërkohë Anamaria është ulur në tavolinë. Ka përballë domatet e prera në dy gjysma, disa kavanozë me perime të konservuara në vaj, një me angjinare, një tjetër me patëllxhanë, pastaj sallam dhe disa feta buke. Ulem, përpiqem të buzëqesh. Ajo më shikon me sy të çuditur.

- Se ç'm'u desh edhe mua të të merrja në shtëpi?

Me sa kuptoj nuk e kapërdin mikpritjen që më ofroi. Sigurisht. Duket sikur nuk e beson as vetë çfarë ka bërë. Unë, ndërkohë, mundohem ta mbaj buzëqeshjen time qetësuese, edhe pse po filloj ta ndiej turpin.

- Të hamë, më mirë.

Bën shenjën e kryqit. E ndjek edhe unë.

- Faleminderit, o Zot, për këtë ushqim dhe për këtë ditë të paqtë. Amin.

Bën përsëri shenjën e kryqit. Përsëritur edhe nga unë.

Më vendos në pjatë njërën nga domatet e ndara në dysh, ndërsa me sy më tregon bukën, ajo nxjerr një angjinare nga kavanozi, e kullon mirë dhe ma jep. Pastaj përsërit të njëjtën gjë me një patëllxhan të madh.

- Na bëftë mirë.

Më përgjigjet me një shënjë të lehtë të kokës.

Angjinaren e gëlltitët të plotë, është e shijshme.

- Sa të mira.
- I bëj vetë, të gjitha zahiretë, dhe reçelrat.
- Të lumshin duart!
- Kur të mbarosh, merre mamin në telefon.

Buka që sapo kisha kafshuar, dukshëm jo e sapodalë nga furra, më mbeti në fyt. Pi një gotë ujë të tërë për ta kapërcyer.

- Fola mbrëmë, edhe me mamin, edhe me xhaxhi Umberton, ai që rri në Gubio, e lamë që do ta marr nesër, nga shtëpia e xhaxhait.

Anamaria mbetet pezull. Unë nuk di ku ta vendos shikimin. Koha që kalon midis nxjerrjes së një gënjeshtre dhe pranimit të saj është e tmerrshme.

- Si të duash. Pas dreke bën mirë të pastrosh dhomën te koteci i pulave.

Sa e tmerrshme pritja, që edhe e mrekullueshme ndjesia që përshkon trupin kur s'bëhet e qartë se gënjeshttra ka kaluar pa u zbuluar.

- Patjetër.

Tani buzëqeshja më del vezulluese, e gjerë sa më s'ka.

Duhet të kujtohem të marr në telefon Marianën. Mamaja është gati të bëjë gjëmën po të marrë vesh që nuk jam bërë i gjallë.

Do të bëhesa lajmi kryesor në televizion.

Koteci është një kub tullash me disa lllamarina në vend të çatisë.

E mata me hapa, për kuriozitet. Muri i gjatë është pesë hapa, pra rreth pesë metra, ai i shkurtri më pak se

katër. Brenda, një mur me tulla me vrima ndan pulat dhe gjelat nga pjesa ku dikur mbanin lepujt. Pjesa që tani do të bëhet dhoma ime e gjumit.

Kur shkova, i armatosur me lopatën, fshesën dhe kovën që më kishte dhënë Anamaria, mund të ketë qenë ora dy e drekës dhe i nxheti brenda i kotecit ishte vetë ferri në tokë. Pak më vonë erdhi edhe ajo, me një karrocë dore të cilën ma la për për të hequr kashtën dhe gjithë çfarë kishte mbetur nga kolonia e lepujve, tashmë të zhdukur. Mbusha dy karroca plot dhe i hodha në oborrin pas shtëpisë, siç më kishte thënë e zonja, pastaj bëra një punë më të imët me fshesë. E mbylla me një kovë me ujë dhe dezinfektues. Pastrimi i dha kënaqësi, ose diçka të ngjashme. Me hap të shpejtë hyri në shtëpi dhe u kthye me një batanije të vjetër, ngjyrë kafe të zbehur. E shtriva si dyshek për natën. Gjatë gjithë kohës, pulat u grumbulluan pas rrjetës metalike që shërbente si mur ndarës për dhomën e tyre, nuk e ndalën asnjë çast bisedën mes tyre, ndoshta pyesnin veten se kush ishte ky fqinj i ri, kjo kafshë me dy putra.

Pak më vonë, Anamaria u kthye me një gotë ujë, ku kishte shtuar disa pika limoni. Nuk kisha ndonjë etje të madhe, kisha pirë gjatë gjithë kohës nga tubi që kishte vënë anës shtëpisë për të ujitur bimët. Nuk e pyeta nëse uji ishte i pijshëm, isha gati ta bëja, por pastaj hoqa dorë, po sikur të më thoshte që nuk pihej?

Aq shumë sa kisha pirë? Më mirë të mos e di.

Me tubin e ujitjes bëra edhe dush. Me mbathje. Anamarinë e paralajmërova, natyrisht. Më tha të lahesha në banjën e saj, por në të vërtetë nuk i dukej aspak keq ideja e dushit në natyrë. Ashtu do t'i duhej të pastronte banjën, edhe pse unë do ta lija akull të pastër.

U ngjita pas murit të shtëpisë, sa më larg syve të kureshtarëve, dhe bëra një dush. Fillova të qeshja, si i marrë. Ishte e qeshur gëzimi. Pashë udhëtimin tim, atë pak rrugë që kisha kryer dhe gjithë pjesën tjetër që më priste, dhe më kapi një lumturi kaq e madhe sa doja të përqafoja veten. Ky udhëtim është gjëja më e bukur që kam përjetuar deri tani. Dhe sapo ka nisur. Për herë të parë, munda turpin, i tregova vetes se mund t'ia dal. Me pak guxim, gjithçka është e mundur. Më ndihmon diçka që nuk e kisha përjetuar kurrë më parë: të pish dhe të hash nuk janë zgjedhje, por janë gjëra të domosdoshme për të jetuar. Instinkti i mbijetesës është më i fortë se turpi. Madje edhe se frika.

Ndërsa thahesha në diell, me peshqirin e plazhit mbështjellë rreth belit dhe mbathjet e varura për t'u tharë, më zunë sytë një varg milingonash, të ndara në dy vija të përsosura, ato që ktheheshin në fole, të ngarkuara me ushqim, dhe ato që niseshin në drejtimin e kundërt, me putrat bosh, si punëtorë që shkojnë të marrin turnin.

E pata zili botën e tyre, e rregullt, e disiplinuar, e përbërë nga individë të gatshëm të punojnë krah për krah për një qëllim, asgjë teorike apo e vështirë për t'u kuptuar, një shtëpi për t'u mbrojtur, breza të tërë pasardhësish të uritur.

Një jetë e kaluar në komunitet. Sepse thjesht është më logjike.

Kafshët u binden gjërave të thjeshta.

Kur kthehem në shtëpi, e gjej Anamarinë duke shtruar darkën. Ora e murit tregon se ka kaluar ora shtatë. Afërsia që ka treguar ndaj meje gjatë ditës ka qenë me hope. Gjatë punës në kotec kisha përshtypjen se ishte më e kënaqur që më më kishte pranë. Tani më pak, shumë më pak. Ndoshta ndihet në siklet që jemi vetëm në shtëpi. Në fund të fundit, nuk më njeh, ndoshta e ka edhe nga frika. Mund të kem edhe qëllime të këqija, këtë ajo nuk ka nga ta dijë.

- Mund të bëj diçka edhe unë?

Më tregon me dorë një gjysmë buke mbi tavolinë.

- Thika është në sirtarin e parë.

Ndërsa pres bukën, i nxitur nga uria, vëzhgoj me kujdes çfarë ka përgatitur për darkë. Në tigan po gatuan një omëletë me qepë, kuptohet që vezët i ka me bollëk, me gjithë ato pula që mban, pastaj perime turshi nga dreka dhe dy domate të prera në gjysmë. E vetmja risi është një shishe e madhe me verë të bardhë.

Anamaria vendos omëletën në pjatë, e sjell në tavolinë.

Gjesti i kryqit më zë disi më të përgatitur.

- Faleminderit, o Zot, për këtë darkë, për ditën që kaloi dhe për atë që do të vijë. Amin.

- Amin.

Këtë herë u tregova më i shkathët, e bëra kryqin përpara saj.

Duke buzëqeshur, Anamaria merr shishen e verës dhe më hedh një gisht në gotë, pastaj e mbush me ujë.

- Pak verë të holluar e meritove sot, je i vogël, por u tregove i zoti me kotecin, prandaj e meriton.

- Faleminderit.

Me shumë dëshirë do t'i tregoja se vetëm dy ditë më parë e kalova gjithë natën duke pirë Negroni dhe pije të tjera të forta, por preferoj të mos them gjë. Kujtimi i asaj nate te “Cocoricò”-ja më sjell ndër mend atë momentin e tmerrshëm që përjetova. Diçka e paharrueshme.

Gotën e saj e mbush plot.

- Na bëftë mirë.

Më përgjigjet njëlloj si në drekë.

Omëleta me qepë është e mrekullueshme, edhe ajo që bën mamaja ime është shumë e mirë, por kjo ia kalon. Ndoshta nga vezët e freskëta.

Hamë pa folur, heshtjen e thyen vetëm zhurma e frigoriferit. Kur mbaron së ngrëni, Anamaria ngrihet dhe shkon tek lavamani. Nuk e kisha vënë re, por brenda ka lënë një pjatë me dy pjeshkë të lara.

- Janë nga oborri i fshatarit që kemi këtu afër.

Merr njërën, e pret në copa dhe i hedh në gotë, pastaj shtie edhe pak verë, derisa i mbulon.

- Nëna ime mbeti e ve kur ishte tridhjetë vjeçe, shumë e re.

Anamaria flet ndërsa me majën e thikës nxjerr një thelë pjeshke nga vera.

- Ishte kohë lufte, një grua e vetme me dy vajza. S'kishte gjë tjetër veç punës, po kujt i duhet një rrobaqepëse në kohë lufte? Varfëria e çmendti. Ishim aq të varfra, sa u bëmë të ashpra. Si ajo, edhe ne. Thoshte që nga uria kishte ngrënë zemrën, të vetën dhe tonën.

Anamaria e mbush edhe një herë gotën deri në gjysmë. E kthen me një frymë.

- Me kalimin e kohës, motra reagoi, e mori veten. Unë kam jetuar pak a shumë gjithmonë në të njëjtën mënyrë, më ka bërë shoqëri Zoti, lutjet. Ajo më thotë që unë nuk i dua njerëzit, dhe ka të drejtë.

E ndërpret fjalën.

Me pjatën në dorë, ngrihem për të pastruar tavolinën, por ajo më ndalon me një lëvizje të kokës, më urdhëron të ulem përsëri.

- E pastoj unë më vonë, s'ka problem. Nuk i dua njerëzit, është e vërtetë. Shoh kaq shumë mosmirënjohje, ndaj Zotit e kam fjalën, ai na ka nxjerrë nga dheu, ndërsa njerëzit sillen si fëmijë të përkëdhelur, të llastuar, me hundën përpjetë. Si ka

mundësi? Edhe kur hamë mut duhet ta falënderojmë Zotin, sepse do të thotë që ekzistojmë.

Anamaria është transformuar, është shpërfytyruar nga zemërimi, shtie edhe gjysmë gotë tjetër.

- Zotin duhet ta zësh në befasi, duhet ta konkurrosh në dashuri, nuk mund të bësh sikur luan shah me të, por nëse hyn në garë dhe fiton, atëherë ai të dëgjon, atëherë mund edhe ta ndajë detin më dysh. Që nga fillimi i kohëve, pak vetë ia kanë dalë.

Përpiqem sërish të ngrihem, me shpresën për t'i dhënë fund këtij momenti vuajtjeje, sepse tani po ndiej vetëm keqardhje për Anamarinë, ka pirë, po flet më shumë seç duhet. I njoh mirë të rriturit kur e teprojnë me pijen; kushedi sa herë e kam parë dajën të dalë përpara meje dhe kushërinjë të tjerë në këtë gjendje. Për të rinjtë është ndryshe, ne pimë për t'u argëtuar, jo për të larguar dhimbjen nga shpirti, siç bëri sonte Anamaria. Por sërish më urdhëron me sy të rri ulur. Tani filloj të shqetësohem unë, ndoshta ka ajo qëllime të këqija, edhe pse është shumë e moshuar dhe e imët për të më trembur me të vërtetë.

- Ti mendon se e kam nga vera, por nuk është ashtu. Po t'i them këto gjëra sepse di t'i lexoj sytë e njerëzve, ti je i ri, por sytë i ke plot me mendime, edhe kur qesh.

E shikoj pa thënë asnjë fjalë. Nuk e prisja që biseda do të zhvendosej tek unë. Anamaria ngrihet, shkon te bufeja, kthehet me një pjatë të thellë në dorë dhe një shishe me vaj ulliri.

- Nëna ime, veç rrobave që qepte, nxirrte edhe ndonjë të ardhur duke hequr syrin e keq, vinin edhe njerëz nga qytezat këtej rrotull. Ishte e zonja. Na e mësoi edhe neve këtë punë, por ime motër nuk donte t'ia dinte. Unë ia heq syrin njerëzve vetëm kur dua vetë, por nuk pranoj kurrë para. Ty ta heq me gjithë qejf, të shohim nëse ke pranë ndonjë njeri që nuk ta do të mirën. Feja nuk e lejon këtë punë, por nëse bëhet për mirë dhe pa pagesë, nuk quhet. Unë e bëj.

- Nuk e di a ia vlen, të them të drejtën...

Një përzierje frike dhe ndrojtjeje, siklet i pafund, tani mendoj gjithë të këqijat e mundshme për Anamarinë.

- Nuk të bëj gjë, mos ki merak!

E mbush pjatën me ujë dhe pastaj hedh vaj në një lugë.

- Ma jep gishtin tregues të dorës së djathtë.

Unë mbetem si i ngrirë, ajo vrenjtet në fytyrë.

- Po të bëj një dhuratë, po të heq syrin e keq të atyre që nuk të duan të mirën, gishtin!

Anamaria ma merr gishtin, e zhyt në vajin e lugës dhe pastaj e lë të pikojë mbi pjatën me ujë. Vëmendjen ia tërheqin pikërisht piklat e vajit në ujë, që përhapen ngadalë. Ndërkohë, thotë disa fjalë të pakuptueshme, ndoshta ndonjë lutje, ose një formulë magjike, mundohem me çdo mënyrë të kuptoj, por është e pamundur.

Që kur filloi rituali ndiej një mpirje të ëmbël, më përkundin gjestet dhe fjalët e saj misterioze, nuk shfaq më kurrfarë rezistence.

Nuk e di sa zgjat kjo punë. Pasi e ka përsëritur disa herë ritualin, më kthen gishtin tregues bashkë me një pecetë për ta fshirë, dhe fillon të vëzhgojë me kujdes një nga një fluskat e vajit që pluskojnë mbi ujë.

- Nuk kisha parë herë tjetër diçka të tillë.

Nuk e di çfarë nuk ka parë herë tjetër. Disi filloj edhe të shqetësohem.

- Dikush shumë pranë teje të ka zili, nuk e di se për çfarë, por të ka zili në një mënyrë të pazakontë.

Anamaria merr pjatën, ngrihet nga tavolina dhe e derdh ujën me vaj në lavaman.

- Tani, për ca kohë, do të jesh i qetë, je i mbrojtur, ama për gjashtë muaj, ndoshta një vit, duhet ta heqësh prapë.

Pa ditur ç'të bëj tjetër, pohoj me kokë.

- Unë po pastroj pak shtëpinë. Ti shko të flesh, merre shishen me ujë me vete, mos të merr etja natën.

Ora është nëntë.

- Në rregull, natën e mirë, atëherë.

- Natën e mirë.

Anamaria më buzëqesh, ose të paktën përpiqet. Të jep përshtypjen sikur atë gjest, si dhe gëzimin që e nxit t'i shfaqet në buzë, të mos e ketë njohur kurrë më parë, ajo përpiqet, por pa sukses. Duhet të të mësoj dikush edhe të buzëqeshësh. Por pa gëzim, është si të mungojë lënda e parë. Anamaria, ashtu si edhe e ëma, gëzimin duhet ta kenë ushtruar pak. Shumë pak.

A është e mundur që një kotec pulash, bashkë me gjithë ç'ka brenda, domethënë erën e kakërdhive dhe llotitjet e pandalura, të duket si pallat mbretëror?

Po. Nëse natën e mëparshme je përpjekur të flesh poshtë një kaçubeje, i përpirë nga mushkonjat dhe lagështira.

Kur shtrihem mbi batanijen që më ka dhënë përzemërsisht Anamaria, dita është ende më se e ndritshme, ndërsa i nxehti është një morsë e padurueshme nën çatinë prej llamarine të kotecit.

Por lumturia i mund të gjitha.

Edhe të nxehtin, i cili bëhet një bashkëudhëtar i mirë. Jam i lumtur. Për gjithçka që po përjetoj. Të paktën këtë herë, një shkrepje e çastit nuk doli aspak e gabuar.

Ndërsa përpiqem të gjej pozicionin e duhur për të fjetur, më vjen ndërmend syri i keq që sapo ma hoqi Anamaria. Ndoshta kjo ma jep këtë ndjesi lumturie. Por në të vërtetë e di që nuk është kështu. Lumturinë e kam njohur gjithmonë. E di mirë se me çfarë force arrin të ma pushtojë trupin dhe të m'i shkëputë këmbët nga toka.

Si atë natë në Sasokorvaro, nxjerr nga valixhja pantallonat e shkurtra dhe bluzën që i kam përzgjedhur si jastëk, dhe i mbështjell mirë.

Ja ku jam. Si gjithmonë, përgjithmonë, në pritje që gjumi të vijë të më gjejë.

Nuk ma kishte marrë mendja, por kakarisja e pulave po më duket e këndshme.

Si një ninullë shtazore, e pandërprerë.